

Nr. 460 Prot.
Datë 25.02.2025



2- Informacioni
[Signature]
Delvinë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1154/1 Prot.

Sarandë, më 26.02.2025

Lënda: Shkresë përcjellëse për afishim.

Drejtuar: BASHKISË DELVINË

Për dajeni: GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT PËRGJITHSHËM SARANDË

Me anë të kësaj shkrese po ju përcjellim bashkëlidhur shkresën e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë me Nr. 00241 Regj. Them., datë 17.02.2025, administruar pranë Bashkisë Sarandë me nr.1154 prot. datë 19.02.2025, për të kryer afishimin për efekt njoftimi të shtetasit **Ziso Xhafer Zhuli, me banim në lagjen Lejla Malo**, në kushtet ku bazuar në ligjin nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", adresa e cituar është pjesë e territorit të Bashkisë Delvinë.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Irena MARJANI



Dr. Juidela
shpallje
20.02.2025
[Signature]

BASHKIA SARANDË
NR. 1154 Prot.
Data 19.02.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GIJKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SARANDË
Nr. 00241 Regj Them. Sarandë me date 17.02.2025.

SHPALLJE - VENDIMI
NE GIJKATË DHE NË BASHKINE DELVINE

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë me vendimin e saj penal nr.23-2022-1415, date 29.09.2022 ka:

VENDOSUR

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Klodian Astrit Pashako, për kryerjen e veprës penale "Vrasja me dashje" parashikuar nga nenet 76 në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim
 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Klodian Astrit Pashako, për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive, parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
 3. Në zbatim të nenit 55 të K.Penal, dënimin përfundimtar të të pandehurit Klodian Astrit Pashako me 10 (dhjetë) vjet burgim.
 4. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit Klodian Astrit Pashako i zbritet 1/3 e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.
 5. Ekzekutimi i vendimit të fillojë nga data e arrestimit të tij 19.10.2016, dhe të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
 6. Në aplikim të nenit 190 të K.Pr.Penale, provat materiale të sekuestruara me procesverbalin e datës 25.08.2013 t'i kthehen personit që i takojnë pasi vendimi të marrë formë të prerë.
 7. Shpenzimet procedurale gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.
 8. Ngarkohet Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me ekzekutimin e këtij vendimi.
 9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.
- U shpall sot në Sarandë, më datë 29.09.2022.

Duke qene se per viktimen Ziso Xhafer Zhuli, banues në Lagjen Lejla Malo Delvine, ka ardhur njoftimi " I panjohur", ne baze te nenit 140/4, 141 te K.Pr.Penale, nxirret kjo shpallje ne Gjykate dhe ne Bashkine Delvine, e cila zë vendin e njoftimit për vendimin penal nr.23-2022-1415, date 29.09.2022.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - I JURIDIKSIONIT TË PARË
K/SEKRETARE
Nexhmie ZENELI